
Adrenaline në harresë

Konkursi "Smiling Cities"

**Visar Haxhibeqiri ,
Miranda Rashani**

Tiranë 03,10,2011

Konkursi "Smiling Cities"

Zona e qytetit: Shtëpia e vjetër e Toptanëve – Tiranë

Projekti: ADRENALINË NË HARRESË

Projekti arkitektonik: Transformimi i shtëpisë në një muze duke rritur kështu njëherazi kualitetin e zonës dhe duke ri-zbuluar gjurmët historike.

NË VEND TË HYRJES

“Projekti ka për qëllim të nxisë debatin publik për zonat e pasura historike dhe monumentale por shpesh të lëna pas dore dhe të kontribuojë në ruajtjen dhe rehabilitimin e këtyre zonave. Një pjesë me rëndësi në qëllimet e projektit është edhe tërheqja e vëmendjes së pushtetit vendor për të parë se çfarë dëshiron vërtet rinia, por edhe t’u krijohet mundësi studentëve të njihen dhe të njohin sipërmarrësit e sektorit që lidhen me profesionin e tyre. Me një fjalë, të shërbeje edhe si një kartë vizite për të nesërmen e këtyre arkitektëve, inxhinierëve apo projektuesve të së ardhmes” A. Berberi

Në kuadër të këtij projekti, ne zgjodhëm zonën tek Tirana e vjetër – hapësira brenda mureve të kalasë së vjetër – shtëpia e Toptanëve.

Në vendin, ku zuri fill Tirana, sot gulon shumë energji. Jashtë mureve të kalasë, një mori njerëzish me destinacione nga më të ndryshmet, në lëvizje pothuajse të përhershme gjeneron energji që në dukje të parë humbet pa u vënë shumë re. Nga ana tjetër, brenda mureve të kalasë heshtja e *“thesarit të pa dukshëm”* vetvetiu përkthehet në një *energji protestuese*.

Orientimi i mirëfilltë i gjithë kësaj energjie – momentalisht me pole të kundërta, do ta riaktivizonte edhe më shumë dhe në mënyrë edhe më kualitative të gjithë zonën e gjenezës së Tiranës – zonë e cila dikur ka qenë ndër pjesët më të pëlqyeshme të të gjithë qytetit, e sot, zbehet nën pluhurin shkatërrues të harresës.

Projekt propozimi në fjalë mëton të tregoj potencialin e fshehur të kësaj hapësire dhe ri-përdorimin e këtij potenciali duke arritur kështu në ri-kualifikim të zonës në tërësi.

ANALIZA:

"Të analizosh përpara se të fillosh do të thotë – të fitosh. Të analizosh, jo pse kërkohet, por pse është më se e domosdoshme dhe tejet e vlefshme"

Zona në fjalë, zënë vend pothuajse në pjesën qendrore të Tiranës së sotme. Realisht pozicionohet në *Lindje* të qytetit, duke mbyllur një kënd të gjerë me boshtin *Veriorë* të orientimit Fig 1. Ka sipërfaqe të përgjithshme prej **16.039 m²** dhe shtrihet në një distancë ajrore prej afërsisht 142 m nga Sheshi qendrorë i qytetit – Sheshi Skenderbeu. Në Veri kufizohet me *Rr. 28 Nëntori*, në Jug me *Bulevardin Zhan D'ark*, në Perëndim me *Blv. Dëshmorët e kombit*, kurse në Lindje kufizohet me *Rr. G. Bush*.




Fig. 1

Ndër objektet funksionale kryesore në zonë, numërojmë: Hotel Dajtin, Galeria e Arteve, Pallati mbretërorë, Shtëpia e Toptanëve, Kinemaja Milenium, Katedralja Shën Pali, Kuvendi i Rep. Shqipërisë, disa objekte ushtarake si dhe objekte tjera përcjellësi (banim etj). Pra, zona përbëhet nga fasha të ndryshme funksionale. Fig.2




Fig. 2

Itineret kryesore brenda zonës përfaqësohen kryesisht nga lëvizja e këmbësorëve. Itinerare të cilat pothuajse në të gjitha drejtimet pengohen dhe nuk finalizohen me destinacionet kryesore. Ato (itineraret) fillojnë nga kufiri i zonës dhe pothuajse të gjitha bllokohen brenda zonës, duke bërë kështu që Zona në tërësi të përjetohej si e ndarë në dy pjesë të mëdha (pjesa veriore dhe ajo lindore) duke mos pasur fare komunikim të ndërsjellët. Kjo ka bërë që brenda zonës të krijohen hapësira pjesërisht të aksesueshme dhe hapësira totalisht të pa aksesueshme. Fig.3. Duket çartë që mu kjo është arsyeja kryesore pse zona nuk zgjon interes të posaqëm tk banorët, edhe përkundër faktit që brenda saj vazhdon të mbahet nën kthetra dhe një pjesë e trashëgimisë arkitekturore kulturore.




Fig. 3

Me mënjanimin e barrierave fizike dhe riorganizimin e ketyre itinerareve kemi arritur që Zona të përjetohet si e tërësishme dhe e aksesueshme nga të gjitha anët. Kështu e gjithë zona shndërrohet në një *hapësirë publike në formë itinerari*, i cili përban funksione të ndryshme dhe të ndryshueshme – kulturore, artistike, rekreative, informuese etj. Njëherit ri-organizmi funksional do të jete motiv shtese që njerëzit të vizitojnë zonën në fjalë Fig. 4.




Fig.4

KONCEPTI: “ADRENALINË NË HARRESË!!!”

SHIKOJNË POR NUK SHOHIN

“....sheh dhe nuhat njëkohësisht një fragment historie të begatshme dikur dhe sot lëngon e harruar në ritmet e hapave të njerëzve të cilët kalojnë atypari me nxitim thjeshtë për t’u larguar nga aty ...”

LARGOHEN PA MEMORI E MBRESA

“...largohen me përtesë....vetëm këmbët ecin,...hunda nuhat,..syri shikon.....por asnjëra prej tyre nuk përçoi asgjë të truri i tyre...nuk lëvizën gurët e rëndë të harresës!!! Ai erdhi dhe u largua pa iu kujtua asgjë dhe pa mbajtur gjë në mendje !!! ... “

Me këtë minipërkufizim sa filozofik po aq dhe poetik, përmbledhim gjithë problematiken e zonës dhe tentojmë t’i japim një zgjidhje po kaq filozofiko-poetike.

“Adrenaline në harresë” – konsiston në faktin që brenda mureve të kalasë ekziston një pjesë e trashëgimise arkitekturore (shtëpia e Toptanëve) e cila nuk shfrytëzohet e aq me pak përjetohet nga vizitoret, qofshin ata të rastësishëm apo të qëllimshëm. Përpara këtij objekti shtrihet një hapësirë mjaft e madhe e cila me projektin tone do të kthehet në një hapësirë të mirëfilltë publike, në kuadër të së cilës si pikë vokale (landmark) do të qëndroj po ky objekt. Njerezit në ndjekje të pavetëdijshme të funksioneve të llojllojshme që do pasurojnë zonën do njoftohen njëkohësisht dhe me vlerat e kësaj trashëgimie duke arritur kështu që kjo pjesë e historisë të vie në pah-ti rikthehet memories së banoreve po me të njëjtin shkëlqim si dikur. Fig.5




Fig. 5

PROJEKTI:

Nga të gjitha ato çka u thanë më sipër përfshi, analizat, identifikimin e problemeve, konceptin, dalë-ngadalë gjeneruan në një projekt ide të mirëfilltë.

E tërë zona depërtohet nga tre itinerare kryesore. Sicili prej itinerareve njëkohësisht paraqet dhe një fashë her-her të veçantë funksionale. Itineraret njëkohësisht arrijnë të shtrihen pa pengesa në gjithë sip. e zonës duke shënuar kështu njëherazi dhe unifikimin e zonës në një të vetme. Gjithsejtë kemi organizuar 5 itinerare kryesore të cilët të nxjerrin mu tek Shtëpia e Toptanëve (landmark) Fig.6. Dy itineraret e para janë pozicionuar nga lulishtja “□□□” që është menduar të funksionoj si magneti i parë i njerëzve që grumbullohen tek “□□□, duke i intriguar ata që të vazhdojnë drejtë brendisë së zonës. Itinerari 3 është i pozicionuar nga bulevardi Zhan d’Ark, i 4 tek Blv. Deshmoret e Kombit dhe tjetri tek rruga “□□□□□” , mu në Portën kryesore e cila të nxjerr në brendinë e Kalasë së vjetër. Ky itinerarë është i plotësuar me aktivitete të antikuarëve duke i shkuar kështu përshtati natyrës arkeologjike të zonës përreth.




Fig.6

Në fillim të këtyre itinerareve, kemi dizajnuar (projektuar) disa struktura të lehta arkitektonike – kryesisht konstruksion çeliku të ndarë në forma trekëndore disa prej të cilave të mbuluara me xhama shumëngjyrësh dhe të lyera me ngjyrë flouroshte dhe të zbukuruar me ndriçim i cili furnizohet me energji diellore, duke bërë kështu që këto pika hyrëse të jenë të dukshme që nga largë, duke i ftuar kështu vizitorët tek brendia e zonës Fig.7



Fig.7

Secili nga këto itinerare, përmban funksione të shpërndara dhe të koncentruara si: Lokale/kafe bare, Park/rekreim, shites ambulant, Ekspozitë artistike, Sheshe, Lokale/dyqane, Antikuare, Film/kinos, kinema mobile, etj, etj. Të gjitha të organizuara në atë mënyrë që nuk i konkurrojnë njëra tjetrës dhe nuk krijojnë pështjellime, por përkundrazi definojnë dhe përforcojnë te 5 rrjetet funksionale si: Rrjetin kulturore, Rrjetin publik, Rrjetin hotelierik, Rrjetin jo-publik dhe Rrjetin e gjelbërimit/rekreimit. Fig.8




Fig.8

Itineraret funksionale bashkohen mu tek Shtëpia e Toptaneve (landmark) duke krijuar kështu dhe *sheshin qendror* i cili është dhe kulmi i përjetime te përgjithshëm të kësaj zone. Duke bere kështu qe zona te riidentifikohet dhe rikualifikohet me një identitet te ri, por pa shkëputje nga e kaluara por përkundrazi duke e theksuar dhe risjelle ne skene atë. Fig 9




Fig 9

Sheshin e kemi emëruar “Syri i thyer”, emër të cilin e merr nga statuja simbolike e cila është e pozicionuar mu në qendrën e tij. Statuja është një konstruksion çeliku me disa pasqyra me kënde të ndryshme të cilat janë të kthyera nga objekti, dhe varësisht nga pozita prej nga shikohen ato pasqyrojnë dukje te deformuara të objektit, duke pasqyruar kështu dhe idenë e deformimeve që pëson Historia po nuk u transmetua nga personat dhe autoritetet përgjegjëse. Pikërisht kjo statujë është dhe momenti i përkthimit ne element arkitektonik të porosisë së performancës të realizuar po për këtë qëllim.

Kështu mbyllet dhe cikli i *Projektimit* që nga *Analiza në Koncept – Koncepti i artikuluar përmes Performancës dhe Performanca e përkthyer në Element domethënës Arkitektonik*.

Në fakt, ky punim është një projekt i cili mëton të largohet nga *projekti konceptual* në udhëtim drejt *projektit ideorë arkitektonik*, por që në vetvete përmban logjikën e shëndoshë të realizimit, gjë që me punë dhe plotësime shtesë të finalizohet dhe në një *Projekt të mirëfilltë zbatues lehtë të realizueshëm*.